

**STANDARDE**

 **PËR ARSIM**

**INTERKULTUROR**

në arsimin e mesëm



Бр. Nr. 12-11647/2  
06-08-2021 20 год. vit  
СКОПЈЕ - ШКУП

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија“ бр.58/00, 44/02, 82/08, 167/10 и 51/11 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ бр.96/19 и 110/19), и Мерка А3.2.1.1 „Изготвување на стандарди за интеркултурализам за секој период од основното образование“ од Акцискиот план составен дел на Стратегијата за развој на концептот за едно општество и интеркултурализам, по доставен предлог од Бирото за развој на образованието, министерот за образование и наука донесе,

### РЕШЕНИЕ

за донесување на Стандарди за интеркултурно образование

1. Со ова Решение се донесуваат Стандарди за интеркултурно образование.
2. Составен дел на ова Решение се Стандардите за интеркултурно образование.
3. Ова Решение влегува во сила со денот на неговото донесување.

### ОБРАЗЛОЖЕНИЕ

Согласно мерка А3.2.1.1 „Изготвување на стандарди за интеркултурализам за секој период од основното образование“ од Акцискиот план составен дел на Стратегијата за развој на концептот за едно општество и интеркултурализам, по доставен предлог од Бирото за развој на образованието, бр. 08-1215/1 од 28.7.2021 година, министерот за образование и наука ги донесе Стандардите за интеркултурно образование.

Согласно наведеното се одлучи како во диспозитивот на ова решение.

Министерка,  
Мила Царовска



Доставено до:

- Биро за развој на образованието;
- Сектор за основно образование,
- архива.

Изготвиле: Билјана Трајковска   
Назихтере Сулејмани 

Ky dokument është përpiluar nga grupi punues i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnime, Forumit Rinor Arsimor, ekspert të arsimit dhe mësimdhënës. Aktivitetet për përpilimin e përmbajtjes së dokumentit janë realizuar në kuadër të Projektit të USAID-it për Integrimin Ndëretnik të të Rinjve në Arsim, i zbatuar nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Byronë e Zhvillimit të Arsimit dhe Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnime. Përmbajtja e dokumentit u përket autorëve dhe nuk i shprehë qëndrimet e Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

#### **Anëtarë të grupit të punës për përpunimin e dokumentit**

1. mr. Gorica Mickovska
2. Biljana Trajkovska
3. mr. Ardiana Isahi Palloshi
4. Ajshe Ajrullai
5. Zhana Zhivadinović
6. Valdete Adili Selimi
7. Dejan Rizinski

#### **Bashkëpunëtorë të cilët morën pjesë në përpilimin e dokumentit**

Besa Reçi dhe Aneta Tërpevska

Ky dokument është përpiluar në bazë të Standardeve për Arsim Interkulturore për arsimin fillor nga grupi i punës i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnime, Forumit Rinor Arsimor, mësimdhënës dhe profesorë universitarë, në përbërje: Ajshe Ajrullai, mr. Gorica Mickovska, Naziktere Sulejmani, Antonella Stojanoska, mr. Adriana Isahi Palloshi, prof.dr. Trajçe Stojanov, prof.dr. Maja Muhiq, mr. Anita Angellovska, Dejan Rizinski.

Aktivitetet për përpilimin e përmbajtjes së Standardeve për Arsim Interkulturore për arsimin fillor janë realizuar në kuadër të projektit "Përforcimi i bashkëpunimit multi-etnik në komuna" i mbështetur nga Fondacioni për Fëmijë Pestaloci dhe "Projekti i USAID-it për Integrimin Ndëretnik të të Rinjve në Arsim", të zbatuar nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Byronë e Zhvillimit të Arsimit.

# PËRMBAJTJA

I	FJALOR	6
II	HYRJE: POZICIONE FILLESTARE	8
III	DOKUMENTE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE SI BAZË	11
IV	PARIME TË PËRGJITHSHME	14
V	PËRCAKTIMI I STANDARDEVE	17
VI	STANDARDET E ARRITJEVE TË NXËNËSVE PËR ARSIM INTERKULTUROR	19
VII	ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE INTERKULTURORE	43
VIII	METODA TË REKOMANDUARA PËR ZHVILLIMIN E KOMPETENCAVE INTERKULTURORE	46

# FJALOR

**Kultura** është tërësia e karakteristikave shpirtërore, materiale, intelektuale dhe emocionale të një shoqërie ose grupi shoqëror, duke i përfshirë të gjitha mënyrat për të qenë në atë shoqëri, duke i përfshirë edhe artin dhe letërsinë, mënyrën e jetesës, mënyrën e bashkëjetesës, sistemet e vlerave, traditat dhe besimet<sup>1</sup>.

**Identiteti** ka të bëjë me ndjenjën personale të njeriut për atë se kush është, ku përket dhe si e identifikon veten. Shumica e individëve kanë një sërë identitetesh të ndryshme me të cilat identifikohen, si personalisht ashtu edhe në aspektin shoqëror. Identitetet personale janë ato të bazuara në attribute personale (tolerant/tolerante, ekstrovert/ekstroverte, i ri/e re, i vjetër/e vjetër, i kujdesshëm/e kujdesshme...), relacione interpersonale (baba, kolegë, bashkëshort, nënë, kolege, bashkëshorte...), narrative autobiografike (nga familje punëtore, me arsim të lartë...). Derisa identiteti shoqëror bazohet në anëtarësi, përkatësi në grupe të caktuara sociale, shoqërore (etnos, komb, religjion, gjini, raca, profesioni, hobi, sport...).

**Identiteti kulturor** ka të bëjë me ato aspekte të identitetit që janë ndarë nga pjesëtarët e një grupi të përbashkët dhe sipas së cilave ato dallohen nga një kulturë tjetër. Identiteti kulturor është i konstruuar në aspektin shoqëror, ndërsa individët kanë identitete të shumëfishta, të cilat ndryshojnë me kohën.

**Multikulturalizmi** „Termi multikulturalizëm e përshkruan diversitetin kulturor të shoqërisë njerëzore. Ai ka të bëjë jo vetëm me elementet e kulturës etnike dhe nacionale por e përfshin edhe diversitetin gjuhësor, religjioz, kulturor dhe socio-ekonomik“<sup>2</sup>. Akoma më saktë, në një dokument tjetër UNESCO është definuar si “interaksion i parë i kulturave të ndryshme dhe mundësi për gjenerimin e përvojave të shpërndara kulturore përmes dialogut dhe respektimit të ndërsjellë“<sup>3</sup>.

**Interkulturalizmi** ka të bëjë me interaksionin (ndërveprimin) e drejtpërdrejtë apo të ndërmjetësuar të dy ose më shumë grupeve të ndryshme kulturore prej cilësdo madhësi, në cilindo nivel të komunikimit të tyre dhe ndikimit të ndërsjellë. Interkulturalizmi është në njëfarë kuptimi reagim ndaj multikulturalizmit dhe kritikës së tij si një model që nuk ofron ndërveprim ndërmjet kulturave të ndryshme dhe integrim të suksesshëm

1 UNESCO. (1982). *Mexico City declaration on cultural policies*. Paris: UNESCO. <[http://portal.unesco.org/culture/en/files/12762/11295421661mexico\\_en.pdf/mexico\\_en.pdf](http://portal.unesco.org/culture/en/files/12762/11295421661mexico_en.pdf/mexico_en.pdf)>

2 UNESCO Guidelines on Intercultural Education, Paris, 2006, 17

3 UNESCO Convention on the Protection and Promotion of the Diversity of Cultural Expressions (2005), Article 8

të anëtarëve të tyre në një shoqëri multikulturore. Në vend të kësaj, interkulturalizmi e promovon konceptin e shkëmbimit kulturor dinamik dhe dialogun dhe interaksionin apo ndërveprimin midis kulturave.

**Integrimi interkulturore** nënkupton qasjen dhe trajtimin e barabartë të kulturave të ndryshme (mund t'i referohet edhe gjinisë së ndryshme, orientimit seksual, racës, statusit social) në të gjitha fushat sociale, duke përfshirë arsimin, punën, shëndetësinë, etj.

**Arsimi interkulturore** koncepti i edukimit interkulturore lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e kompetencave interkulturore dhe i referohet aftësisë të nxënësve për të kuptuar dhe praktikuar konceptin e (diversitetit) integrimit në të jetuarit në botën globale të diversitetit.

**Kompetencat interkulturore** janë tërësia e njohurive, qëndrimeve, sjelljeve, aftësive dhe vlerave, në funksion të realizimit të dialogut interkulturore dhe integrimit interkulturore.

# HYRJE: POZICIONE FILLESTARE

Karakterit multikulturore dhe multi-etnik i shtetit tonë dhe nevoja e njohjes dhe bashkëpunimit më të madh të ndërsjellë, paraqesin sfidë që kërkon angazhime të bashkuara për të vënë në aksion angazhimet prioritare për zhvillimin e arsimit interkulturore si bazë për komunikimin e ndërsjellë dhe interaksionin (ndërveprimin) midis bashkësive të ndryshme etnike. Përcaktim i përgjithshëm është (sipas rregullores normative<sup>4</sup>, për çka ka edhe konsensus të gjerë shoqëror) në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ta respektojë parimin e interkulturalizmit, që nënkupton zhvillimin e qëndrimeve, aftësive dhe njohurive që kontribuojnë për fitimin e kompetencës interkulturore përmes mësimdhënies dhe nxënies, në mënyrë që gjeneratat e ardhshme të jenë të përgatitura siç duhet për të jetuar në një shoqëri multikulturore dhe të marrin pjesë në mënyrë të suksesshme në një mjedis gjithnjë e më global. Arsimit interkulturore duhet të kontribuojë për zhvillimin e jetesës në një realitet multi-etnik dhe multikulturore në shtet, të përballur me nevojën e tolerancës, me mos diskriminimin, respektimin, pranimin si edhe vlerat e tjera universale dhe humane. Në këtë drejtim në vitin 2019, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Strategjinë nacionale për zhvillimin e konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizëm me plan veprues 2020-2022, në të cilin qartë është përkufizuar nevoja në sistemin arsimor të ndërmerren masa dhe aktivitete për arsimin interkulturore ku bëjnë pjesë edhe standardet për interkulturalizëm në sistemin arsimor.

Në përmirësimin e cilësisë së arsimit një prej tendencave është zhvillimi i standardeve dhe kompetencave, që kontribuojnë për arritjen e qëllimeve arsimore. Për këto arsye, në vitin 2006, Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian e miratuan Rekomandimin për kompetencat kyçe për nxënien e përjetshme (të rishikuar dhe të plotësuar disa herë, deri në vitin 2018)<sup>5</sup>. Ai duhet të kontribuojë në realizimin e vizionit të BE-së për një "rajon evropian arsimor", përmes së cilit do të mund ta përdorë të gjithë potencialin e arsimit dhe kulturës në shtetet evropiane, përmes hapjes së vendeve të punës, drejtësisë sociale dhe qytetarëve aktivë. Arsimit me këtë jep mundësi të ndërtohet por edhe të jetësohet identiteti evropian në të gjitha diversitetet e tij.

Me këtë rekomandim, pritet prej vendeve anëtare "ta sigurojnë zhvillimin e kompetencave kryesore për të gjithë, si pjesë e strategjive të tyre për nxënien e përjetshëm, duke i përfshirë edhe strategjitë për arritjen e edukimit universal dhe

4 Aktet normative relevante janë dhënë më tej në pjesën: Dokumente kombëtare dhe ndërkombëtare si bazë

5 <[https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv:OJ.C\\_.2018.189.01.0001.01.ENG&toc=OJ.C:2018:189:TOC](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv:OJ.C_.2018.189.01.0001.01.ENG&toc=OJ.C:2018:189:TOC)>



t'i shfrytëzojnë kompetencat kyçe për nxënien e përjetshme – kornizën referente evropiane“. Me miratimin e tij, rekomandimi mbetet dokumenti kryesor referent në vendet e Evropës për zhvillimin e arsimit, të orientuar drejt kompetencave. Në këtë dokument të rëndësishëm evropian për arsimin, janë definuar gjithsej 8 (tetë) kompetenca, thelbësore për qytetarët, për zhvillimin e tyre personal, për stil jetësor të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, punësim, shoqëri aktive dhe inkluzion social“. Është evidente që qytetari aktive dhe inkluzion janë disa nga vlerat themelore të BE-së. Si rrjedhojë, aspekti i multikulturës dhe integrimi interkulturore, paraqet prioritet qendror për BE-në. Për t'u arritur kjo, është e nevojshme të zhvillohen kompetenca interkulturore përkatëse të cilat janë vendosur kryesisht në fushat: Kompetenca shoqërore dhe qytetare dhe Kompetenca për vetëdije kulturore dhe ekspresion kulturor.

Duke i pasur parasysh rekomandimet për zhvillimin e kompetencave kryesore përmes sistemit arsimor dhe nevojën e standardeve për ndjekjen e zhvillimit të këtyre kompetencave, Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bazë të propozimit të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit në mars të vitit 2021 solli, për herë të parë, Standarde kombëtare për arsimin fillor në të cilat janë përcaktuar kompetencat që duhet t'i fitojnë nxënësit në fund të arsimit fillor.

Gjatë definimit të kompetencave që janë të përfshira në Standardet kombëtare është përdorur Korniza evropiane e kualifikimeve, në pajtim me të cilat kompetencat kryesore paraqesin kombinim të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve. Standardet kombëtare janë vendosur edhe në planin mësimor, përmes përfaqësimit të lëndëve mësimore dhe aktiviteteve jashtëshkollore, në programet mësimore, përmes shndërrimit të kompetencave në rezultate të pritura nga mësimi dhe si rrjedhojë e tyre në standarde për vlerësim.

Duke e pasur parasysh rekomandimin e Këshillit të Evropës për zhvillimin e kompetencave interkulturore përmes procesit të arsimit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bazë të Standardeve kombëtare në shtator të vitit 2021, solli Standarde për arsim interkulturore (në arsimin fillor).

Meqë zhvillimi i kompetencave interkulturore nuk përfundon me përfundimin e arsimit fillor, por është proces që vazhdon në arsimin e mesëm por edhe më tej në jetë dhe është pjesë e procesit të nxënies së përjetshme.

Në përmbushjen e qëllimeve strategjike si hap logjik i radhës është përpunimi i Standardeve për arsim interkulturore në arsimin e mesëm. Këto standarde më tej do të inkorporohen edhe në Standardet kombëtare për arritjen e nxënësve në arsimin e mesëm. Me ndihmën standardeve, konkretizohen rezultatet nga nxënia me çka bëhen të kuptueshme dhe përshkrime të matshme empirike për arritje, gjegjësisht për sjelljen e nxënësve. Standardet për arsimin interkulturore në arsimin e mesëm duhet të shërbejnë edhe si bazë gjatë definimit të kompetencave kyçe "kompetencën sociale dhe qytetare" dhe "ndërgjegjien dhe të shprehurit kulturor".

# DOKUMENTE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE SI BAZË

Standardet e propozuara interkulturore bazohen në dokumente relevante kombëtare dhe ndërkombëtare.

**Dokumentet kombëtare** në vijim, në të cilat idetë për multikulturalizmin dhe integrimin ndëretnik dhe ndërkulturore janë futur si vlera, vizione dhe qëllime, kanë shërbyer si pikënisje gjatë përpunimit të këtyre standardeve:

➔ *Strategjia për arsimin dhe plani i veprimit 2018-2025;*

➔ *Strategjia kombëtare për zhvillimin e konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizëm me plan veprimi 2020-2022 të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*

➔ *Koncepti i arsimit interkulturore;*

➔ *Koncepti i arsimit fillor;*

➔ *Standarde kombëtare për arsimin fillor, që definojnë kompetencat kyçe në fund të arsimit fillor;*

➔ *Standarde për arsimin interkulturore (për arsimin fillor);*

➔ *Koncepti për modernizimin e arsimit teknik;*

➔ *Indikatorët për cilësinë e punës së shkollave;*

➔ *Doracaku për vlerësimin integral, që paraqet kornizë metodologjike për matjen e cilësisë së procesit arsimor;*

➔ *Programi mësimor për lëndën e arsimit qytetar në arsimin e mesëm profesional.*

Bazë e përpilimit të këtij dokument ishin të gjitha përvojat e deritanishme, praktikatat e mira dhe dokumentet të Projekti *Forcimi i bashkëpunimit multietnik në komunitet, i mbështetur nga Fondacioni për fëmijë Pestalocci, Modeli Nansen për arsimin e integruar i realizuar nga Qendra Nansen për dialog (QND) Shkup, Projekti për Integrim Ndëretnik në Arsim (PINA) dhe Projekti për Integrimin Ndëretnik e të Rinjve në Arsim (INRA) të mbështetur nga USAID-i, dhe të tjerë.*

**Dokumente ndërkombëtare**, që janë përdorur si orientime bazë ishin:

*European Reference Framework of Key Competences for Lifelong Learning* (Korniza evropiane për kompetencat kyçe për nxënie të përjetshme), që ishte baza pedagogjike, formale e standardeve, derisa në aspektin e përmbajtjes i referohen:

➔ *UNESCO Guidelines on Intercultural Education*<sup>6</sup> (Udhëzime të UNESCO-s për arsim interkulturore), që në fakt paraqet, „instrument për vendosjen e standardeve, si rezultat i hulumtimeve dhe konferencave të shumta, veçanërisht nga takimi i ekspertëve i mbajtur në UNESCO, mars 2006”<sup>7</sup>, që mund të shërbejë si udhëzues për ndërtimin e politikave në këtë fushë;

➔ *UNESCO Intercultural Competences: Conceptual and Operational Framework*<sup>8</sup> (UNESCO kompetenca interkulturore: Kornizë konceptuale dhe realizuese) ku janë paraqitur konceptet themelore, terma nga fusha e interkulturalizmit dhe kompetencave interkulturore dhe të cilat paraqisnin bazën në përkufizimin e termeve themelore në dokumentin tonë;

➔ *Intercultural competence for all: Preparation for living in a heterogeneous world*<sup>9</sup> (Kompetenca interkulturore për të gjithë: Përgatitje për jetë në një botë heterogjene) ku ofrohet pasqyrë e detajuar teorike dhe praktike në “zhvillimin e kompetencave interkulturore si element kyç në arsimin mejnstrim (arsimin e rregullt)”<sup>10</sup>;

6 <<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000147878>>

7 <<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000147878>>, fq.7

8 <<https://en.unesco.org/interculturaldialogue/resources/132>>

9 <[https://www.coe.int/t/dg4/education/pestalozzi/Source/Documentation/Pestalozzi2\\_EN.pdf](https://www.coe.int/t/dg4/education/pestalozzi/Source/Documentation/Pestalozzi2_EN.pdf)>

10 *Intercultural competence for all: Preparation for living in a heterogeneous world*, Council of Europe Pestalozzi Series, No2., Council of Europe Publishing, 2012, fq., 6

- 
- OSBE: Udhëzime nga Lubjana për integrimin e shoqërive të ndryshme<sup>11</sup> prej ku buron themeli për integrimin si qëllim kyç i minoriteteve në shoqëritë multietnike;

- 
- *Reference Framework of Competences for Democratic Culture*<sup>12</sup> (Kornizë referente e kompetencave për kulturë demokratike<sup>13</sup>), që paraqet udhërrëfyesin sistematik për arsim demokratik, që nga edukimi parashkollor e deri te arsimi i lartë;

- 
- Edhe publikime, hulumtime dhe praktika të tjera të mira, referuese ndërkombëtare.
- 

---

11 Organization for Security and Co-operation in Europe, 2012 <<https://www.osce.org/files/f/documents/9/4/100450.pdf>>

12 **Reference Framework of Competences for Democratic Culture, Vol.1-3**, Council of Europe <<https://www.coe.int/en/web/reference-framework-of-competences-for-democratic-culture/rfcdc-volumes>>

13 <[https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2019/11/Referentna\\_ramka-Kompetencii\\_za\\_Demokratska\\_kultura-kniga\\_3.pdf](https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2019/11/Referentna_ramka-Kompetencii_za_Demokratska_kultura-kniga_3.pdf)>

# PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet në të cilat mbështetet ky dokument janë nxjerrë nga një dokument ndërkombëtar dhe disa dokumente vendore. Dokumenti ndërkombëtar është UNESCO - *Doracak për arsimin interkulturore*, ndërsa prej dokumenteve vendore: *Ligji për Arsim të Mesëm*, *Ligji për Arsim Profesional dhe Trajnim*, *Koncepti për modernizimin e arsimit teknik si edhe Strategjia nacionale për një shoqëri dhe interkulturalizëm*.

## 1

### *UNESCO - Doracak për arsimin interkulturore:*

- ➔ Arsimi interkulturore respekton identitetin kulturor të nxënësit/nxënëses, përmes sigurimit të arsimit të pranueshëm kulturor, të përshtatshëm dhe cilësor për të gjithë;
- ➔ Arsimi interkulturore i mundëson secilit nxënësi/nxënëseje të fitojë njohuri, aftësi dhe qëndrime të domosdoshme për integrimin e tij/të saj aktiv dhe integrimin e plotë në shoqërinë multikulturore;
- ➔ Arsimi interkulturore i mundëson çdo nxënësi/nxënëseje të fitojë njohuri, aftësi dhe qëndrime që do t'i mundësojnë të kontribuojë për mirëkuptimin, respektimin, tolerancën, solidaritetin dhe bashkëpunimin midis individëve të grupeve të ndryshme etnike, sociale, kulturore dhe religjioze.

## 2

*Ligji për Arsimin e Mesëm<sup>14</sup>*

Në pajtim me Ligjin për Arsimin e Mesëm, parimet për arsimin e mesëm në të cilat bazohet ky dokument janë:

- ➔ Interesi më i mirë dhe zhvillimi i plotë i nxënësit/nxënëses;
- ➔ Barazia, qasja dhe inkluzioni;
- ➔ Avancimi i ngjashmërive dhe pranimi i diversitetit, interkulturalizmit, multikulturalizmit.

Gjithashtu, dokumenti bazohet edhe në nenin 3 të të njëjtit ligj, i cili thotë: “Nuk lejohen diskriminime të bazuara në gjini, racë, ngjyrë të lëkurës, origjinës nacionale dhe sociale, bindjes politike dhe fetare, pozitës pronësore dhe shoqërore, ...” Ligji gjithashtu cakton se shkollat kontribuojnë për zhvillimin e multikulturalizmit, integrimin ndëretnik dhe tolerancën.

## 3

*Ligji për Arsim Profesional dhe Trajnim<sup>15</sup>*

Në pajtim me Ligjin për Arsim Profesional dhe Trajnim, qëllime dhe detyra të arsimit profesional dhe trajnimit në të cilat bazohet ky dokument janë:

- ➔ Të zhvillojë kompetenca, njohuri dhe aftësi të domosdoshme për aktivitetet profesionale të personit, si edhe për vetëpunësim në kuadër të shoqërisë së bazuar në parimet tregtare dhe demokratike dhe
- ➔ Të sigurojë baza për nxënien e përhjetshme.

14 Ligji për Arsim të Mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/2003, 42/2003, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numëri 229/20) <<https://mon.gov.mk/al/page/?id=2055>>

15 Ligji për Arsim Profesional dhe Trajnim („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 71/06, 117/08, 148/09, 17/11, 24/13, 137/13, 41/14, 145/15, 55/16, 64/18 dhe 275/19) <<https://mon.gov.mk/al/page/?id=2055>>

## 4

*Koncepti për modernizimin e arsimit teknik*

Koncepti për modernizimin e arsimit teknik parashikon që përmes edukimit teknik të reformuar nxënësit do të edukohen dhe përgatiten si qytetarë të përgjegjshëm, konstruktivë dhe demokratikë, përgjegjës për jetën personale dhe shoqërore. Funksionet bazë të arsimit teknik përfshijnë, ndër të tjera, jo vetëm fitimin e kualifikimeve, gjegjësisht kompetencave përkatëse profesionale të nevojshme për përfshirje në botën e punës, por edhe përvetësimin e kompetencave kyçe për nxënien e përjetshme sipas aftësive të individit dhe zgjerimin dhe zhvillimin njohurive të fituara.

## 5

*Strategjia kombëtare për zhvillimin e konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizëm*

Vizioni i Strategjisë kombëtare për zhvillimin e konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizëm thotë: Republika e Maqedonisë së Veriut e ndërtuar mbi konceptin "Një shoqëri për të gjithë" me interkulturalizëm të zhvilluar. Për ne, një shoqëri për të gjithë nënkupton: njohjen e të gjitha diversiteteve, garantimin dhe sigurimin e barazisë, drejtësisë sociale, drejtësisë, mundësive të barabarta, përfshirjes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe arritjen e kohezionit shoqëror." Kjo strategji e shikon interkulturalizmin si përgjigje ndaj sfidave të shoqërisë së Maqedonisë së Veriut. Më tej, në strategji është përcaktuar se interkulturalizmi është lidhur me vlera, siç janë: të drejtat e njeriut, demokracia, kultura e paqes dhe dialogut, si dhe identiteti evropian.



# PËRCAKTIMI I STANDARDEVE

Standardi paraqet deklaratë për njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë, si dhe vlerat, respektivisht qëndrimet që pritet t'i fitojnë nxënësit deri në përfundimin e arsimit të mesëm. Kjo nënkupton se standardet duhet të jenë të formuluar në shprehje të qarta, matëse për pritshmëritë, të shprehura në formë të rezultateve nga nxënia.

Duke e marrë parasysh se standardet duhet të jenë të bazuara në të dhënat empirike, niveli i realizimit të tyre mund të matet në mënyrë periodike. Kjo, gjithashtu, do të thotë se cilido standard nuk është i përcaktuar një herë e përgjithmonë. Në fakt, rekomandohet që të njëjtat të rishikohen në periudhë prej 4-5 viteve, varësisht nga dinamika e arritjes së tyre. Vendosja e standardeve është proces i vazhdueshëm, i lidhur ngushtë me përmbajtjen, me rrethanat, me kontekstin historik, shoqëror, politik, por edhe shkencor.

Gjatë përkufizimit të standardeve është marrë parasysh që ato t'i kenë **karakteristikat** vijuese:

## | a | Verifikueshmëri të rezultateve të caktuara nga nxënia

Kjo do të thotë se standardi arsimor duhet t'i referohet njohurive, aftësive, shkathtësive dhe qëndrimeve konkrete, të matshme;

## | b | Kuptueshmëri

Standardet janë formuluar në mënyrë të qartë, koncize dhe të saktë me terme të kuptueshme për të gjithë pjesëmarrësit në sistemin arsimor;

## | c | Realizueshmëri

Standardet arsimore paraqesin sfidë arsimore, por megjithatë jo aq të mëdha që të mos mund të jenë të realizuara. Kjo do të thotë se janë përkufizuar në mënyrë që të jenë të realizueshme gjatë procesit arsimor;

## | ç | Fokus në njohuritë themelore

Kjo do të thotë se standardet i konkretizojnë **rezultatet themelore nga nxënia**, respektivisht njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë strukturore, ato nuk e paraqesin në detaje fushën e përgjithshme të arsimit interkulturore ose, nga ana tjetër, nuk tentojnë ta mbulojnë përmbajtjen e përgjithshme, por vetëm atë më të rëndësishmen, respektivisht më të domosdoshmen;

*/ d | Kumulativiteti*

Që do të thotë se standardet lidhen me standardet për arsim fillor, për të cilat supozohet se në masë të madhe janë arritur.

*/ dh | Detyrueshmëria*

Kjo do të thotë se kompetencat e përshkruara në standardet janë të detyrueshme për të gjithë nxënësit në procesin arsimor;

*/ e | Diferencimi*

Standardet duhet të diferencohen qartë nëpër domene.

Kompetencat interkulturore shprehen përmes domeneve vijues:

1. njohuri dhe të kuptuarit;
2. aftësi dhe shkathtësi dhe
3. vlera dhe qëndrime.

Në këtë kuptim do të mund të thuhej se kompetencat interkulturore kanë të bëjnë me “nxënie për të ditur”, “nxënie për të bërë” dhe “nxënie për të qenë”. Nxënia për të ditur është hapi i parë në përvetësimin e kompetencave interkulturore. Nxënia për të bërë është momenti aktiv, me të cilin fillon bashkëveprimi me të tjerët gjatë të cilit dituria e përvetësuar zbatohet, por përvetësohet edhe dituri e re në mënyrë kthyesë, përmes vetë procesit të bashkëveprimit. Nxënia për të qenë, në fakt është krijim i “individit interkulturore”, individ i aftësuar që përmes të menduarit dhe sjelljes refleksive dhe kritike, të hyjë në lidhje të shëndosha dhe të frytshme me kultura të ndryshme, të jetë qytetar/qytetare produktiv/produktive në botën globale dhe të larmishme.

# STANDARDET E ARRITJEVE TË NXËNËSVE PËR ARSIM INTERKULTURORE

## TERME THEMELORE NË PËRKUFIZIMIN E STANDARDEVE

Gjatë përcaktimit të standardeve ndiqet parimi si vijon: janë përkufizuar termet themelore nga fusha e multikulturalizmit dhe integritit interkulturore dhe në bazë të tyre janë zhvilluar standarde përkatëse që nxënësi/nxënësja duhet t'i përvetësojë nga kjo fushë deri në përfundimin e arsimit të tij të mesëm. Është e vështirë të ndahen këto terme themelore për shumë arsye. Pa u futur në shpjegim të detajuar, në vazhdim janë cekur shtatë termet themelore për të cilat vlerësojmë se e përfshijnë tërësisht fushën e multikulturalizmit dhe integritit interkulturore. Ato janë:

1. Identitet kulturor;
2. Multikulturë;
3. Interkulturë;
4. Drejtësi dhe barazi sociale;
5. Stereotipa dhe paragjykime;
6. Paqe dhe zgjidhje paqësore e konflikteve;
7. Globalizim.

Për secilën nga termat/fushat e përmendura nga interkultura janë zhvilluar standarde për arsim interkulturore në bazë të kompetencave (njohuri dhe të kuptuarit, aftësi/shkathtësi/sjellje, vlera dhe qëndrime) për arsimin e mesëm, pavarësisht nëse bëhet fjalë për arsimin e përgjithshëm të mesëm, atë artistik ose të mesëm profesional.

## Identiteti kulturor

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standarde për vlerësim
Njohuri dhe të kuptuarit	E shpjegon termin identitet kulturor dhe mënyrat e formimit dhe manifestimin e identitetit kulturor të individit dhe grupit.	Me gojë ose me shkrim i përshkruan aspektet e identitetit kulturor dhe formimin e tij nën ndikimin e grupeve të ndryshme subkulturore.
Aftësi/shkathësi/sjellje	I hulumton dhe në mënyra të ndryshme i prezanton identitetin personal dhe identitetet e tjera kulturore në bashkësi.	Zbaton studime/hulumtime lidhur me identitetin kulturor, i diskuton njohuritë dhe në mënyra të ndryshme (verbalisht, me shkrim, në mënyrë grafike, multimediale) i prezanton.
Vlera dhe qëndrime	E pranon dhe e vlerëson identitetin personal kulturor dhe me përkushtim punon në afirmimin e vetes dhe bashkësisë dhe është i hapur/e hapur për ndryshime pozitive.	Përmes sjelljes, shkrimit, të folurit dëshmon se e vlerëson identitetin personal, se punon në zhvillimin personal dhe avancimin e kulturës së jetesës në bashkësi.

## Shembuj për aktivitete

- ➔ Nxënësit në grupe të vogla me ndihmën e letërsisë, filmave, dëshmime të personave që kanë mësuar/jetuar në vende të caktuara, i hulumtojnë kulturën e jetesës ose sjelljen në kontekste të ndryshme, për shembull në një kampus studentor dhe/apo në një kompani të njohur të huaj, i prezantojnë njohuritë para të tjerëve dhe diskutojnë për ngjashmëri dhe dallime me mjedisin e tyre dhe sfidat nga të jetuarit në një mjedis tjetër kulturor.

---

- ➔ Nxënësit në grupe të vogla me ndihmën e letërsisë, filmave, dëshmime nga përvojat personale, i studiojnë strategjitë e sjelljes së grupeve kulturore që janë në pakicë në një mjedis dominues (integrim, izolim, asimilim, marginalizim) dhe diskutojnë për pasojat për identitetin personal dhe identitetin multikulturore.

---

- ➔ Nxënësit krahasojnë përshkrime të identitetit të pjesëtarëve nga një kulturë e caktuar me përshkrimet që për ta i japin pjesëtarët e një kulture tjetër. Diskutojnë për dallimet, arsyet dhe pasoja e dy perspektivave të ndryshme.

---

- ➔ Në paralele ose në shkollë (si pjesë e aktiviteteve zgjedhore ose të lira dhe/apo aktiviteteve të projekteve) realizohen debate në temë si: A mundet/a duhet në shoqërinë globale të ruhet identiteti i pjesëtarëve të kulturave të veçanta?

---

- ➔ Nxënësit bëjnë intervista me nxënës/miq/anëtarë të familjes për atë se si ata i shohin, çfarë u rekomandojnë të bëjnë ose të mos bëjnë dhe ngjashëm. Çdo nxënës/nxënëse i përgatit pyetjet prej përpara. Në fund gjithsecili i përmbledhë përgjigjet prej të intervistuarve, bën reflektim dhe shkruan nëse dhe çfarë ka mësuar për veten dhe se si do të ndikojë kjo mbi të. Intervistat është mirë të incizohen që të analizohen më saktë.

---

- ➔ Përmes stuhisë së ideve nxënësit numërojnë grupe të ndryshme kulturore. Mësimdhënësi/mësimdhënësja e plotëson listën nëse ka nevojë. Secili nxënës/secila nxënëse për veten shkruan çfarë kontakte, mendime dhe ndjenja ka për secilin prej grupeve. Në grupe të vogla (5-6) nxënës diskutojnë dhe bëjnë rezime se si ata janë të lidhur dhe si sillen me grupet e ndryshme kulturore. Në mënyrë plenare dhe kritike analizojnë se sa janë të kënaqur nga gjendjet e konstatuara dhe çfarë do të dëshironin/duhej të ndryshonin.

- Nxënësit nga perspektiva e 20-viteve që vijnë (në ardhmëri) shkruajnë biografinë e tyre. Supozojnë se janë person i suksesshëm në një fushë të caktuar dhe përshkruajnë se si ia kanë dalë të bëhen (për shembull: nëse dhe si rrethi ka ndikuar në suksesin që kanë arritur).

---

  - Nxënësit e krahasojnë identitetin e tyre personal me identitetin kulturor të grupit që i takojnë (për shembull: bashkëmoshatar, etnik, social, religjioz dhe tjetër) dhe e hulumtojnë ndikimin e grupit mbi identitetin e tyre personal. Njohuritë i prezantojnë përmes një eseje shkencore, krijimi letrar, vepër arti, dramatizimi, prezantimi verbal.

---

  - Çdo nxënës/nxënëse në mënyrë individuale i identifikon ndikimet kryesore të identitetit të tyre kulturor. Më pas, në grupe të vogla diskutojnë çfarë i bën të ngjashëm dhe çfarë të ndryshëm dhe cilët faktorë kanë ndikuar në këtë. Aktiviteti mund të përfundojë me ese letrare ose shkencore.

---

  - Nxënësit përmes stuhisë së ideve i paraqesin karakteristika e identitetit të njerëzve. Më pas, në mënyrë individuale i hulumtojnë duke përdorur letërsia/internet dhe i plotësojnë. Në grupe të vogla i klasifikojnë sipas rëndësisë së tyre, dukshmërisë, qëndrueshmërisë, universalitetit... i prezantojnë (në mënyrë verbale, grafike ose në ndonjë mënyrë tjetër) dhe diskutojnë dhe i nxjerrin konstatimet që në fund paraqesin një rezimë për studimin e identitetit kulturor.

---

  - Nxënësit e studiojnë ndikimin e kulturës së punës në kompani të ndryshme (reale apo të përmbledhura) dhe ndikimin e saj mbi efikasitetin e kompanisë dhe jetën private të të punësuarve. Në mënyrë të argumentuar diskutojnë për konstatimet, bëjnë zgjedhje personale për atë se në çfarë kompanie dëshirojnë të punojnë.

---

  - Nxënësit lexojnë tregime ose vepra më voluminoze, shikojnë film në të cilin përshkruhet kultura e jetesës në një mjedis të caktuar, mësimdhënësi/mësimdhënësja në mënyrë të orientuar, përmes pyetjeve, i nxitë të mendojnë dhe të bisedojnë për pyetje të identitetit kulturor (zhvillimit, faktorëve, rëndësisë për individin dhe grupin).
-

- ➔ Nxënësit në terren i hulumtojnë karakteristikat kulturore dhe të identitetit të disa subgrupeve të caktuara kulturore rinore (grupe tifozë, muzikorë, politike, p.sh., pankerë, metal, rokerë,...) dhe diskutojnë për ta, për stereotipat dhe paragjykimet lidhur me disa prej tyre.
  - ➔ Shkolla/mësimdhënësi/mësimdhënësja vendosin bashkëpunim me shkollat e qyteteve të tjera, me gjuhë mësimore të ndryshme dhe/ apo nga vende të tjera (në kuadër të projekteve të ndryshme për bashkëpunim shkollor dhe shkëmbim), nxënësit kontaktojnë përmes rrjeteve elektronike, e vizitojnë njëri-tjetrin, organizojnë ngjarje të ndryshme (reale virtuale) dhe njoftohen me veçantitë kulturore dhe ngjashmëritë.
  - ➔ Shkolla gjatë javës organizon aktivitete të ndryshme në të cilat nxënësit e prezantojnë kulturën e tyre dhe/apo kultura të tjera përmes vizatimeve, artikujve, shfaqjeve, ushqimit, këngëve, lojërave sportive... Në aktivitete mund të përfshihen edhe prindër si edhe nxënës të shkollave me të cilat bashkëpunon shkolla.
-

## Multikultura

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standarde për vlerësim
Njohuri dhe të kuptuarit	Shpjegon se multikulturalizmi është vlerë që kontribuon për zhvillimin personal, zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e përgjithshme.	Përmes analizës identifikon shembuj ku respektimi dhe mbështetja e kulturave të ndryshme është vlerë që jep përfitim në planin ekonomik, social dhe personal.
Aftësi/shkathësi/sjellje	Ndërmerr nismë për vendosjen e marrëdhënieve interpersonale të bazuara në respekt dhe mirëkuptim me pjesëtarët e bashkësive të ndryshme kulturore.	Punon në projekte, hulumtime, shkëmbimin e përvojave, në mënyrë joformale shoqërohet me persona/nxënës me origjinë të ndryshme të identitet dhe kulturore.
Vlera dhe qëndrime	I respekton dhe i mbështetë vlerat e ndryshme kulturore të pranishme në mjedis dhe më gjerë.	Merr pjesë dhe nxit aktivitete në të cilat marrin pjesë përfaqësues të kulturave të ndryshme. Analizon përfitimet nga aktivitetet e përbashkëta dhe promovon përfitime të multikulturës si vlera shoqërore.



## Shembuj për aktivitete

- ➔ Nxënësit në mënyrë individuale e plotësojnë pyetësorin „Kuizi kulturor“. Qëllimi është vetëvlerësimi lidhur me njohjen e kulturave të tjera. Më pas hapet diskutimi: “Nëse dhe në çfarë mënyre njohja personale dhe kontaktet me përfaqësuesit e kulturave të tjera kontribuojnë për pasurimin e njohurive për kulturat e tjera dhe pranimin e tyre”.
- ➔ Nxënësit në grupe bëjnë hulumtim për një nga dhjetë vendet e zhvilluara në botë/Evropë. Kriteret për zgjedhje mund të jenë: vende të zhvilluara ekonomike, cilësia e jetës dhe ngjashëm. Hulumtohet midis tjerash me theks të veçantë edhe: përbërja e popullatës për nga përkatësia religjioze, nacionale/ose për nga origjina, gjuha dhe ngjashëm. Diskutim vazhdon lidhur me rezultatet.
- ➔ Nxënësit luajnë role dhe diskutojnë. Nxënësve u ndahen kartela me përshkrim të statusit të caktuar në shoqëri. Gjithsecili duhet të debatojë në pajtim me statusin e ndarë nga kartela me temë “Udhëtimi i radhës do të jetë Londra”. Pas disa minutash nxënësit grupohen në pajtim me statusin e tyre dhe diskutojnë: Si janë ndjerë si pjesëtarë të grupit me status më të lartë dhe nëse kanë qenë të privilegjuar, nëse e kanë ndryshuar sjelljen në pajtim me statusin, analizohet nëse kjo është e drejtë. Diskutimi vazhdon me identifikimin e situatave reale të jetës ku personat janë diskriminuar.
- ➔ Intervistë me një punëdhënës. Çdo nxënës/nxënëse e ka për detyrë të intervistojë nga një punëdhënës. Pyetjet kryesore kanë të bëjnë me kë bashkëpunojnë, cilët janë klientët, prej ku furnizohen me material dhe mjete të nevojshme, cila është përbërja e të punësuarve, sfidat në bashkëpunim që i referohen dallimeve kulturore dhe ngjashëm. Në mënyrë të argumentuar diskutojnë për konstatimet, bëjnë konstatime personale ndërsa nxjerrin edhe konkluzione se gjatë punës do të duhet të bashkëpunojnë me persona të cilët u takojnë kulturave të ndryshme.

- Nxënësit e ndarë në grupe marrin detyrë të përgatisin agjendë turistike për një grup turistësh që dëshirojnë ta vizitojnë RMV-në dhe të njoftohen në kulturën dhe traditën e vendit. Nxënësit duhet ta prezantojnë shtetin në dritë pozitive, si multikulturore dhe multietnike. Detyra e dytë është të analizojnë sa vendet e propozuara që do të vizitohen janë të rëndësishme vetëm për një kulturë/etnik, si dhe sa janë të rëndësishme për të gjitha kulturat/etniket që jetojnë në RMV.
  - Nxënësit marrin detyrë individuale për të shkruar ese me temën “Përparësitë dhe sfidat e jetës në shoqëri multikulturore dhe multietnike”. Eseja më e mirë do të shpërblehet. Kriteret për vlerësim përgatiten nga nxënësit dhe mësuesit, ndërsa elementet për vlerësim midis tyre janë edhe argumentet e dhëna për përparësitë e shoqërisë multikulturore dhe rëndësinë e shembujve të dhënë dhe shqyrtimeve nga perspektiva personale.
-

## Interkultura

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësjja:	Standarde për vlerësim
Njohuri dhe të kuptuarit	Shpjegon se dimensionet e ndryshme kulturore dhe kapacitetet e tyre krijojnë ndërvarësi dhe vlera të përbashkëta kulturore.	Përmes analizës së situatës, i identifikon vlerat e kulturës së vet, vlerat e kulturave të tjera dhe identifikon vlerat e përbashkëta kulturore.
Aftësi/shkathtësi/sjellje	Bashkëpunon në mjedise të ndryshme kulturore për fusha të rëndësishme për të gjithë.	Merr pjesë në aktivitete dhe jep një kontribut aktiv në arritjen e një qëllimi të përbashkët për anëtarët e grupeve të ndryshme kulturore.
Vlera dhe qëndrime	Beson se ndërveprimi midis kulturave të ndryshme dhe ndikimeve të ndërsjella është baza për të mësuar demokracinë dhe kontribuon për një jetë më të mirë të përbashkët në një shoqëri.	Përmes hulumtimeve dhe sjelljeve praktikon shkëmbimin interkulturore dhe promovon përfitime prej tij për individin dhe shoqërinë.

## Shembuj për aktivitete

- ➔ Nxënësit e ndarë në grupe realizojnë aktivitete që kanë për qëllim ta zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë ndaj grupit. Realizohen aktivitete me ç'rast kërkohet nga nxënësi/nxënësja në grup të gjejë nxënës/nxënëse me ngjyrë të syve si sytë e tij/saj ose jep/japin kriter apo kritere të tjera. Pasi të grupohen sipas ngjyrës së syve ose ndonjë karakteristike tjetër, lihen vetë të identifikojnë karakteristika kulturore që janë të përbashkëta për të gjithë përfaqësuesit në grup. Bëhet diskutim lidhur me atë se si ndjehen në grup kur kanë cilësi të cilat janë të përbashkëta për të gjithë përfaqësuesit në grup.
- ➔ Nxënësit në mënyrë individuale shkruajnë karakteristika për kulturën e tyre dhe identifikojnë karakteristika që i njohin edhe në kulturat e tjera. Diskutohet në grup "të përzier" të nxënësve dhe identifikohen vlerat e ngjashme të kulturave të ndryshme.
- ➔ Në paralele ose në shkollë realizohen debate me temë: Si u dukemi atyre që janë të ndryshëm prej nesh? A jemi vërtetë kaq të ndryshëm? A jemi më shumë të njëjtë sesa të ndryshëm?
- ➔ Në nivel të shkollës organizohet punëtori me nxënës me origjinë të ndryshme kulturore/etnike me temë "Këshilli zgjedh për të ardhmen e pjesës historike dhe kulturore të qytetit". Simulimi organizohet mbi situatën hipotetike vijuese: "Autoritetet lokale kanë përgatitur propozim – plan urbanistik për qendrën e qytetit në të cilin jetoni. Në atë pjesë ka shtëpi të vjetra të stilit tradicional të rajonit dhe për këtë arsye janë karakteristikë e rëndësishme e identitetit kulturor lokal. Por standardi i banimit atje nuk është modernizuar. Plani urbanistik parasheh prishjen e pjesës së vjetër të qytetit dhe ndërtimin e objekteve banesore të reja moderne. Një pjesë e përfaqësuesve lokalë janë pro që të ruhet identiteti kulturor lokal, ndërsa të tjerët vlerësojnë se qyteti duhet të modernizohet dhe duhet të ndërtohet në mënyrë moderne dhe të jetohet siç jetohet në vendet bashkëkohore". Nxënësit ndahen në pesë grupe edhe atë: grupi 1 – pushteti lokal që e propozon planin; grupi 2 – pushteti lokal që është kundër planit; grupi 3 – qytetarët që jetojnë në pjesën e vjetër të qytetit; grupi 4 – ekspertë (arkitektë, urbanistë); grupi 5 – përfaqësues të mediave. Duhet të zgjidhet një kryesues/kryesuese dhe ndihmësit që e udhëheqin debatin. Pas debatit diskutohet me nxënësit: Cilat janë vlerat e përbashkëta kulturore të shtetit, nëse ato na përfaqësojnë të gjithë ne dhe nëse duhet të krenohemi me to?

- 
- Nxënësit ndahen në pesë grupe. Bëhet kujdes gjatë formimit të grupeve ato të formohen prej nxënësve me origjinë të ndryshme kulturore ose, nxënës që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore. Kërkohej prej grupeve të shkruajnë prezantim të shkurtër në një rreth prej temave të ardhshme: 1. shkolla ime; 2. shoqëria ime; 3. lokalitetet e trashëgimisë botërore të vendit tim. Më pas mësimdhënësi/mësimdhënësjja siguron që prezantimet të shkëmbehen me shkollë të vëllazëruar nga një shtet tjetër ose me një shkollë partnere nga një komunë tjetër në shtet. Shkëmbimi bëhet duke i përdorur mediat për komunikim. Analizohen prezantimet dhe bëhet krahasim i prezantimeve. Bisedohet edhe për atë se si mediat e reja për komunikim i bashkojnë njerëzit nga të gjitha anët e botës, që nuk ka qenë e lehtë kur prindërit e tyre kanë qenë të rinj.
  - Mësimdhënësi/mësimdhënësjja i angazhon nxënësit që t'i shprehin ndjenjat e tyre për ngjarjet e mëdha historike (për shembull, Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore, robëria...) që kanë prodhuar paragjykime, jotolerancë dhe diskriminim, si edhe nevoja për të ardhme të qetë, kështu që do të shkruajnë hartime, këngë, do të vizatojnë vizatime, do të përpilojnë afishe, do të kompozojnë këngë ose do të shprehin përmes një forme tjetër. Mësimdhënësi/mësimdhënësjja i nxit t'i lidhin gjërat lidhur me atë se çfarë dinë tjetër për identitetin, trashëgiminë, historinë, zbulimet e kulturave që studiohen në atë ngjarje. Nëse njohja e kulturave të tjera dhe mënyra e tyre e jetesës, trashëgimia e tyre dhe ekzistenca e tyre, ndihmon për të kuptuar vërtetë, vlerësuar dhe respektuar popujt e tjerë dhe rrethimin global?
-

## Drejtësia dhe barazia sociale

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standarde për vlerësim
Njohuri dhe të kuptuarit	I shpjegon të drejtat universale të njeriut, gjykon në mënyrë kritike për rastet e shkeljes së ndonjë të drejte të njeriut dhe i njeh në mënyrë përkatëse institucionet dhe mekanizmat për tejkalimin/zgjidhjen e padrejtësisë sociale.	I referohet Deklaratës universale të të drejtave të njeriut (KB) në situata konkrete të shkeljes së ndonjë të drejte të njeriut dhe i shpjegon kompetencat dhe rolin e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare në zgjidhjen e problemeve të shkaktuara nga padrejtësia sociale.
Aftësi/shkathtësi/sjellje	I analizon faktorët (socio-politikë, ekonomikë, historikë etj.), që çojnë drejt paraqitjes së anshmërisë, pabarazisë dhe padrejtësisë ndaj individëve dhe grupeve të njerëzve (pjesëtarëve të bashkësive të marginalizuara), tregon empati dhe gjen mënyra për tejkalimin e padrejtësisë përmes institucioneve përkatëse.	Në mënyrë aktive merr pjesë në promovimin e barazisë në shkollë, detekton (identifikon) situata reale konkrete të pabarazisë sociale në shoqëri dhe inicion aksione për vokalizimin e problemit dhe presion publik mbi institucionet për tejkalimin e pabarazisë.

<p>Vlera dhe qëndrime</p>	<p>E njeh/pranon përgjegjësinë e vet në ndërmarrjen e aksionit kundër paraqitjes së padrejtësisë dhe pabarazisë në rrethimin e tij dhe vlerëson se të gjithë duhet t'i respektojnë dhe zbatojnë të drejtat e njeriut.</p>	<p>Në situata konkrete të padrejtësisë sociale dhe pabarazisë argumenton se çdo njeri pa dallim identitetit të tij personal ose grupor ka të drejta të njëjta për jetë cilësore dhe e potencon përgjegjësinë qytetare individuale si të domosdoshme për ndryshim pozitiv në shoqëri.</p>
---------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

---

## Shembuj për aktivitete

- ➔ Nxënësit lexojnë lajme për pabarazinë sociale, p.sh. për lagjen e Shuto Orizares në të cilën banorët janë lënë pa mbrojtje shëndetësore në kohë pandemie (<<https://www.radiomof.mk/sred-pandemija-1-200-deca-i-4-000-vozasni-od-shuto-orizari-se-ostaveni-bez-osnovna-zdravstvena-zashtita/>>), diskutojnë për arsyet dhe pasojat, detektojnë bazën e diskriminimit dhe shkurtimin e të drejtës së mbrojtjes shëndetësore dhe japin shembuj si mund të përfshihen në zgjidhjen e problemit, si ata do të ndjeheshin ata në një situatë të tillë.

---

- ➔ Nxënësit bëjnë hulumtim për shoqatën "Glasen tekstilec" (ose ndonjë shoqatë të ngjashme që angazhohet për të drejtat e një grupi të caktuar) dhe i prezantojnë konstatimet duke përfshirë çfarë punon shoqata, si u ndihmon punëtoreve të tekstilit, nëse ata janë privuar nga të drejtat dhe si mund t'u ndihmohet edhe më tutje.

---

- ➔ Nxënësit e ilustrjnë hartën e lagjes Taftalixhe në Shkup me rrugë emrat e të cilave i pasqyrojnë qytetet/vendet që në mënyrë solidare janë përfshirë në ndërtimin e Shkupit pas tërmetit, diskutojnë se pse Shkupi quhet Qytet i Solidaritetit dhe bëjnë përshkrim çfarë do të thotë solidariteti dhe empatia për ta në përmasa ndërkombëtare pavarësisht diversitetit kulturologjik.

---

- ➔ Nxënësit shikojnë video të situatave reale të brutalitetit policor në Republikën e Maqedonisë së Veriut edhe në Evropë/botë. I analizojnë shembujt, hulumtojnë se çfarë i ka çuar në këtë situatë dhe diskutojnë nëse policia ka të drejtë në situatat konkrete të zbatojë forcë, nëse cenohet liria e njerëzve dhe/apo shkelen të drejtat e tjera të njeriut.

---

- ➔ Nxënësit e ndarë në grupe të vogla hulumtojnë në faqen e Entit për Statistikë se sa është paga minimale, paga më e lartë dhe mesatare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Më pas, përmes faqeve të dyqaneve/marketeve të ndryshme në Shkup formojnë shportën konsumatore me shujtat kryesore për një familje katëranëtarëshe dhe diskutojnë se sa është fuqia blerëse e familjeve me të ardhura të ndryshme dhe nëse të gjithë kanë qasje për një jetë cilësore.

---



- Nxënësit hulumtojnë kulturat e ndryshme (joballkanike) për atë se sa pavarësohen të rinjtë (në çfarë moshe largohen nga shtëpia familjare) dhe konstatimet i krahasojnë me përvoja personale në shtëpi dhe në Ballkan. Më pas, diskutojnë për arsyet se pse të rinjtë në vendin tonë më vonë ose asnjëherë nuk largohen nga shtëpia familjare dhe se si institucionet mund të ndihmojnë në këtë drejtim.
  - Nxënësit i hulumtojnë organizatat sindikaliste dhe bëjnë prezantim se cili është funksioni i tyre, pse janë të nevojshme dhe nëse janë efikase në punë.
  - Nxënësit i hulumtojnë arsyet për krizën e emigrantëve edhe me ndihmën e vejlës onlajn <<https://www.bbc.com/news/world-middle-east-32057601>> në mënyrë virtuale përballen me sfidat e refugjatëve nga Siria. Më pas, hulumtojnë se si vendet e ndryshme sillen me emigrantët dhe diskutojnë për (mos)pranimin e emigrantëve në shoqërinë tonë dhe nëse shkelet e drejta e tyre e njeriut.
  - Nxënësit e ndarë në grupe të vogla lexojnë për kushtet në burgje në të cilat të burgosurit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në Suedi e vuajnë dënimin me burg dhe i zbatojnë kushtet e burgut në të dyja vendet. Më pas në mënyrë plenare diskutojnë për të drejtat e të burgosurve dhe risocializimin e tyre pas përfundimit të dënimit me burg.
  - Vizitë e qendrës sociale “Dunja” në Shkup (ose të ndonjë organizate të ngjashme në një qytet tjetër) me qëllim të njoftimit me punën e qendrës, mënyrën e organizimit dhe financimin përmes bisedës/intervistë me aktivistë të qendrës.
  - Nxënësit organizojnë aksion për vokalizim (ose zgjidhjen) e një problemi konkret të padrejtësisë sociale në mjedisin lokal dhe/ apo organizojnë aksione/fushata onlajn për ngritjen e vetëdijes për përdorimin e drejtësisë dhe barazisë sociale, solidaritetit dhe empatisë.
-

## Paqja dhe zgjidhja paqësore e konflikteve

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standarde për vlerësim
Njohuri dhe të kuptuarit	I identifikon faktorët që kontribuojnë për paraqitjen dhe zhvillimin e konflikteve interpersonale dhe i shpjegon pasojat e konflikteve si edhe parimet dhe aftësitë për zgjidhjen e konflikteve.	Nga jeta e përditshme numëron arsye për paraqitjen e konflikteve konkrete dhe jep veprime konkrete për parandalim ose zgjidhjen e situatave kontestuese që çojnë drejt konfliktit.
Aftësi/shkathtësi/sjellje	Gjatë zgjidhjes së konflikteve zbaton qasje të barabartë që i merr parasysh perspektivat e ndryshme të palëve të involvuara në konflikt.	Merr pjesë në zgjidhjen apo parandalimin e situatës së simuluar ose reale të konfliktit me ç'rast nuk tregon anshmëri dhe nuk ndërmerr anë në një situatë konfliktuozë për shkak të dallimit ose ndonjë specifike të palëve në konflikt
Vlera dhe qëndrime	Dëshmon përkushtim për zgjidhjen paqësore të situatave konfliktuozë dhe për kënaqësinë nga zgjidhja të palëve të involvuara	Udhëzon në aplikimin e proceseve/ndërmjetësimit paqësor gjatë zgjidhjes së konflikteve, në mënyrë përkatëse i përdorë teknikat e ndërmjetësimit në procesin e zgjidhjes së konfliktit që çojnë drejt zgjidhjes me konsensus.

## Shembuj për aktivitete

- ➔ Nxënësit e ndarë në grupe fitojnë listë pune me tekst për shembull konkret të situatës konfliktuale interpersonale që del nga dallimet kulturore. Detyrë e nxënësve është me kujdes ta lexojnë tekstin dhe më pas t'i identifikojnë arsyet për paraqitjen e konfliktit të përshkruar në listën e punës. Më pas prezantohen arsyet, mësimdhënësi/mësimdhënësja i regjistron në tabelë/flipçart dhe bëhet diskutim për atë se cilat arsye të tjera i kanë identifikuar në jetën e tyre të përditshme ose kanë pasur mundësi të lexojnë në libra, revista, të shikojnë në televizor ose internet. Bashkërisht sillen konkluzion se duhet të parandalohen arsyet që e shkaktojnë konfliktin.

---

- ➔ Mësimdhënësi/mësimdhënësja u tregon nxënësve video të konflikteve interpersonale të bazuara në dallimet kulturore. Më pas nxënësit e plotësojnë listën e punës me pasojat e mundshme të konflikteve të paraqitura, kështu që i lidhin pasojat e mundshme me situatën konfliktuale. Pas prezantimit shfaqet dhe epilogu i videos diskutohet për atë se si të parandalohen përfundimet fatale ose të këqija e situatave konfliktuale.

---

- ➔ Në klasë dramatizohen dy situata, njëra kur gjatë zgjidhjes së konfliktit merret anë sipas përkatësisë etnike të të përfshirëve në konflikt, ndërsa në tjetrën veprohet në pajtim me rregullat për zgjidhjen e situatave konfliktuale. Më pas diskutohet për pasojat dhe sfidat nga veprimi në njërin apo rastin tjetër.

---

- ➔ Përmes dramatizimit nxënësit i ushtrojnë teknikat për ndërmjetësim me skenar të përgatitur prej përpara. Më pas diskutohen procedurat e aplikuar dhe sillen konstatimet për atë se cilat janë teknikat e përgjithshme për udhëheqjen e procesit të ndërmjetësimit.

---

- ➔ Mësimdhënësi/mësimdhënësja u tregon nxënësve një situatë konfliktuale dhe prej tyre kërkon të shkojnë drejt zgjidhjes së konfliktit me konsensus. Nxënësit punojnë në grupe dhe në fund i prezantojnë zgjidhjet e tyre. Më pas diskutohet për zgjidhjet e prezantuara dhe konstatohet për përfitimet e zgjidhjeve me konsensus.

---

- Në nivel të shkollës formohet dhe punon ekipi për ndërmjetësim. Definohet roli i ekipit (të përfshihet në zgjidhjen e konflikteve midis nxënësve dhe në mesin e nxënësve dhe mësuesve, përmes ndërmjetësimit). Për anëtarët e ekipeve, psikologu dhe pedagogu i shkollës organizojnë trajnim për ndërmjetësim.
  - Teknika „Unë flas“: Nxënësit e ndarë në grupe të vogla kanë për detyrë të pasqyrojnë një skenë konfliktuale (me mundësi nga përvoja personale) në të cilën nuk u ka pëlqyer mënyra e komunikimit. Të ndarë sipas roleve skenën e dramatizojnë para të gjithë paraleles. Më pas, e kanë për detyrë t'i riformulojnë fjalitë që përmbajnë komunikim të dhunshëm përmes teknikës “unë flas” (hapi: 1. „Kur e shoh se... (në mënyrë të padhunshme përshkruhet procedura e personit tjetër“); 2. „unë ndjej.../dëshiroj të... (shprehën ndjenjat e folësit pa u akuzuar ose arsyetuar“); 3. „Do të dëshiroja/që... (personi flet për rezultatin/ndryshimin e dëshiruar“).
-

## Stereotipa dhe paragjykime

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësj:	Standarde për vlerësim
Njohuri dhe të kuptuarit	E shpjegon dallimin midis stereotipave dhe paragjykimeve, lidhjen midis tyre, si edhe pasojat negative prej tyre mbi personin dhe shoqërinë.	Përmes shembujve të ndikimit negativ të paragjykimeve dhe stereotipave ndaj të ndryshmëve nga vetja i shfaq rezultatet negative nga sjella e tillë.
Aftësi/shkathtësi/sjellje	Në mënyrë kritike e analizon anshmërinë stereotipe në materialet digjitale dhe të shtypit, si edhe në komunikimet ndërnjerëzore dhe gjatë të folurit dhe sjelljes personale.	Përdorë informacione nga burime të ndryshme (të shtypura, elektronike ose të drejtpërdrejta) e kontrollon saktësinë/besueshmërinë tyre, veçanërisht kur të dhënat kanë të bëjnë për kultura të tjera ose bashkësitë etnike ose për kulturën dhe bashkësinë e tyre.
Vlera dhe qëndrime	Beson se bashkëpunimi i përbashkët, të kuptuarit dhe respekti janë bazë për tejkalimin e paragjykimeve dhe stereotipave.	Bashkëpunon me pjesëtarët e grupeve të ndryshme etnike, kulturore dhe sociale dhe merr pjesë në aktivitete që promovojnë thyerjen e stereotipave dhe paragjykimeve midis bashkëpunëtorëve dhe më gjerë.

## Shembuj për aktivitete

- ➔ Nxënësit ndahen në çifte. Njëri ose njëra prej tyre merr një listë me stereotipe dhe paragjykime për përfaqësues konkretë të një grupi etnik/kulturore/social dhe me to duhet të përpilohet tregim që do ta transmetojë komunikimin me bashkëmoshatarin/bashkëmoshataren që është në çift, ndërsa nxënësi/nxënësja tjetër duhet t'i zbulojë stereotipat dhe të jep fakte që e thyjnë stereotipin. Biseda ndërpritet me shenjë të mësimdhënësit/mësimdhënëses dhe më pas bëhet diskutim për atë se cilat stereotipa i kanë përdorur? Si janë ndjerë kur i kanë përdorur dhe si kur i kanë dëgjuar? Sa kanë qenë bindëse faktet e dhëna për shkatërrimin e stereotipave dhe zvogëlimin e paragjykimeve? Në fund konstatohet se stereotipat dhe paragjykimet janë të dëmshme për individët por edhe për shoqërinë në përgjithësi.
- ➔ Nxënësit e ndarë në grupe marrin material me përmbajtje interkulturore. Grupi i parë merr një pjesë të një gazete ditore, grupi i dytë një link të një lajmi nga një portal konkret, grupi i tretë shikojnë TV- emision dhe grupi i katërt merr njoftim me gojë nga një kalimtar rasti ose nga një mik. Nxënësit e kanë për detyrë informacionin e marrë ta verifikojnë me të paktën dy burime të tjera dhe më pas ta transmetojnë informacionin si të verifikuar deri tek të gjithë bashkëmoshatarët e tjerë. Në fund bëhet diskutim për atë nëse verifikimi i informacionit i ka konfirmuar informacionet ose kanë ardhur deri në të dhëna krejtësisht të reja.
- ➔ Nxënësit marrin detyrë për të ideuar një projekt me të cilin do të kontribuojnë për përmirësimin e gjendjes ndëretnike në shkollën/mjedisin/komunën e tyre me temë: Ndal stereotipave dhe paragjykimeve. Në projekt është duke u punuar së bashku me nxënësit e bashkësive të tjera etnike në mënyrë që të ideohen slogane/parulla/pamfleta dhe më pas ndahen në shkollë/lagje/komunë ngjiten parullat dhe sloganet në korridorin e shkollës, në billborde, etj.

- 
- ➔ Udhëtim me tren: Nxënësit e marrin një situatë të ideuar për udhëtim me tren në një destinacion të gjatë. Në kupenë në të cilën udhëtojnë ka vend për vetëm edhe tre udhëtarë që vetë duhet t'i zgjedhin nga lista e ofruar (p.sh. rome me tre fëmijë të vegjël, dixhej nga Kosova, tifoz i Vardarit, feministe nga Greqia, polic i moshës së mesme, një ushtar i armatosur i NATO-s, një punonjëse e mëparshme seksuale, një djalë i ri në karrocë invalidi, një vajzë me shami e cila flet vetëm në gjuhën turke, etj.). Më pas, nxënësit ndahen në grupe të vogla të përziera në të cilat me konsensus duhet të vendosin cilëve tre udhëtarë do t'u lejojnë të udhëtojnë me ta. Çdo grup e prezanton rezultatin duke e shpjeguar procesin e zgjedhjes, cilët faktorë kanë qenë vendimmarrës, cilin/cilën më së paku kanë dashur ta pranojnë në kupe, cilat stereotipa dhe paragjykime i kanë vërejtur në diskutimin grupor.
- 
- ➔ Barometri i njeriut: Klasa shndërrohet në një bosht imagjinar. Muri i majtë shënon një rëndësi pikë përfundimtare - „plotësisht nuk pajtohem“, ndërsa muri i djathtë - „plotësisht pajtohem“. Nxënësit dëgjojnë deklarata që përfshijnë stereotipa dhe paragjykime dhe fizikisht pozicionohen në klasë, varësisht qëndrimit të tyre për një deklaratë konkrete. Shembuj për deklarata: *Të gjithë romët janë muzikalë; Nuk e kam problem të jem në lidhje me ndonjë të bashkësisë etnike tjetër; Shqiptarët dhe maqedonasit urrehen; Nuk shoqërohem me njerëz që nuk kanë para për piqe; Të gjithë myslimanët janë terroristë; Gratë janë drejtuese të këqija të automjeteve, etj.* Pasi nxënësit të pozicionohen pas deklaratës së dhënë, zgjidhet një vullnetar/vullnetare që shpjegon se pse është pozicionuar pikërisht në atë vend të boshtit.
- 
- ➔ Nxënësve u prezantohen disa fotografi dhe ato duhet ta qëllojnë se cili person është fotomodel. Në një rëndësi prej fotografive është Xheni Rank, modele me madhësi plus ([https://en.wikipedia.org/wiki/Jennie\\_Runk](https://en.wikipedia.org/wiki/Jennie_Runk)), ndërsa fotografitë e tjera janë të njerëzve që nuk janë fotomodelë. Nxënësit shpjegojnë cilën fotografi e kanë zgjedhur dhe pse. Më pas, diskutojnë për normat shoqërore dhe mendimet e imponuara.
-

➔ Nxënësit e shqyrtojnë hartën në linkun vijues <<https://alphadesigner.com/mapping-stereotypes/europe-according-to-luxembourg?rq=europe%20according%20to%20luxembourg>> dhe diskutojnë për atë se si ndjehen lidhur me përshkrimet e dhëna në hartë. Më tej, hulumtojnë për librin "Atlasi i paragjytimeve" dhe hartat qesharake që i ilustron autori Janko Cvetkov.

---

➔ Nxënësit në mënyrë anonime shkruajnë hartim me temë „Edhe unë kam qenë viktimë e paragjytimeve” përmes së cilës i prezantojnë njohuritë e shqyrtuara për pasojat negative të etiketimit mbi çdo bazë.

---



## Globalizimi

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësjja:	Standarde për vlerësim
Njohuri dhe të kuptuarit	E shpjegon ndërvarësinë e vendeve dhe shoqërive në rajon dhe në botë në lidhje me informacionin, teknologjinë, lidhshmërinë ekonomike dhe kulturore.	Në mënyra të ndryshme (p.sh. verbale, tekstuale, grafike, multimediale, etj.) i përshkruan dhe shpjegon lidhshmërinë informatike, teknologjike, ekonomike dhe kulturore të vendeve dhe shoqërive në rajon dhe botë.
Aftësi/shkathtësi/sjellje	Në mënyrë kritike i analizon dhe në mënyrë të argumentuar i diskuton përfitimet dhe sfidat e mobilitetit global mbi zhvillimin e qëndrueshëm (progresin social, zhvillimin ekonomik dhe mjedisin jetësor).	E planifikon, prezanton dhe diskuton planin për arsimin/punësimin/zhvillimin e mëtejshëm në karrierë, duke i pasur parasysh mundësitë dhe sfidat e shoqërisë globale.
Vlera dhe qëndrime	Pranon se çdo njeri pa dallim shtetit, përkatësisë etnike, kulturore, fetare, sociale dhe ndonjë përkatësie tjetër është pjesë e shoqërisë së përbashkët dhe i ndajnë vlerat dhe përgjegjësitë e bazuara në të drejtat e njeriut.	Përfshihet dhe inicion nisma lokale për kontribut ndaj çështjeve globale (shkencë, ekologji, të drejta, varfëri ...).

## Shembuj për aktivitete

- ➔ Nxënësit bëjnë hulumtim: Ku janë prodhuar gjësendet që i përdorim? Më pas bëjnë rezyme: Çfarë dinë për vendet ku prodhohen ato? Pse i importojmë dhe nuk i prodhojmë?; Në çfarë kushtesh punëtorët i prodhojnë ato?; Kush përfiton më së shumti nga prodhimtaria?; Pse ekonomia botërore është e strukturuar kështu? etj.
- ➔ Nxënësit i analizojnë dhe i diskutojnë përfitimet civilizuese nga ngjarjet kryesore të globalizimit kulturor, p.sh. përhapjen e kulturës antike, rrugën e mëndafshhtë, paraqitjen e televizionit satelitor, internet, etj.
- ➔ Nxënësit diskutojnë për disa nga qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm, pse janë ato të rëndësishme për vendet dhe botën në tërësi, grumbullojnë dhe analizojnë të dhëna për arritjen e tyre në vendin tonë, si ato i tangojnë personalisht ata, dhe njohuritë i paraqesin në mënyra të ndryshme.
- ➔ Nxënësit në grupe të vogla shpjegojnë dhe diskutojnë për mendimet dhe përvojat personale për migrimet, shkollimin dhe punën jashtë vendit, njohjen e gjuhëve dhe çështje të ngjashme lidhur me qytetarinë globale.
- ➔ Nxënësit bëjnë hulumtim për preferencat e tyre kulturore: çfarë muzike dëgjojnë, prej nga vijnë, çfarë filmash shikojnë, ku janë prodhuar ato, cilët i kanë idhuj të muzikës, filmave dhe sportit, cilat rrjete sociale i përdorin, sa miq i kanë nga jashtë, si komunikojnë me ta, çfarë ndikon pozitivisht dhe çfarë negativisht në veçantinë e tyre kulturore.
- ➔ Nxënësit (në mënyrë individuale apo në grupe të vogla) i hulumtojnë dhe i analizojnë aspektet pozitive dhe negative të globalizimit në fushat e ndryshme: ekonomi, kulturë, politikë, sport... dhe i prezantojnë në mënyrë grafike, përmes eseve letrare dhe shkencore, në mënyrë multimediale.
- ➔ Nxënësit në çifte diskutojnë cilat njohuri dhe aftësi u nevojiten nëse zgjidhen në kuadër të projektit për shkëmbimin e nxënësve vitin e ardhshëm t'i kalojnë disa muaj ose një vit në praktikë/shkollim në një vend konkret jashtë shtetit, me ndihmën e internetit gjejnë të dhëna relevante për vendin. Bëjnë plan se çfarë duhet të bëjnë që të përgatiten në mënyrë më së miri të mundshme.

# ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE INTERKULTURORE

## Sigurimi i interkulturalizmit<sup>16</sup>

Në pajtim me rregulloren normative dhe përcaktimet e pranuar shoqërore, që të sigurohet mënyrë e qëndrueshme e jetesës së përbashkët në shoqërinë tonë multikulturore/multietnike, arsimi përfshin aktivitete dhe përmbajtje që e promovojnë respektimin e diversitetit kulturor dhe interaksionin midis nxënësve që janë pjesëtarë të bashkësive të ndryshme etnike dhe që mësojnë në gjuhë të njëjtë ose të ndryshme mësimore.

Interkulturalizmi në arsim sigurohet në mënyra të ndryshme. Njëra mënyrë është përmes futjes së përmbajtjeve multikulturore (verbale, vizuale dhe/apo auditive), që i promovojnë karakteristikat kulturore të të gjitha bashkësive etnike/religjioze që jetojnë në vendin tonë dhe/apo tregojnë për interaksionin midis pjesëtarëve të këtyre bashkësive. Këto përmbajtje duhet të jenë të pranishme në programet mësimore për të gjitha lëndët, gjithmonë kur kjo është e mundur, si edhe në tekstet shkollore dhe materialet mësimore.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit në arsimin gjimnazor dhe përmbajtjet e programuara nga shkollat e mesme profesionale ofrohen edhe të tilla, të cilat janë pjesërisht ose tërësisht të përkushtuara në fitimin e njohurive për karakteristikat kulturore/etnike të të gjithëve që jetojnë në RMV, si edhe potencimin e interesave të përbashkëta dhe vlerave të të gjithë qytetarëve në vendin tonë, si edhe pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike. Gjithashtu, mund të organizohen kurse për mësimin e të gjitha gjuhëve që përdoren në mësimdhënie.

Interkulturalizmi përforcohet edhe përmes organizimit të aktiviteteve për integrimin ndërëtnik. Këto janë gjegjësisht aktivitete të përbashkëta mësimore<sup>17</sup> dhe aktivitete të përbashkëta jashtëshkollore<sup>18</sup> e grupe të „përziera“ të nxënësve që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore. Aktivitetet e tilla janë shumë të rëndësishme për sigurimin e interaksionit midis nxënësve të cilët nuk kanë mundësi që në një mënyrë tjetër të kontaktojnë dhe të bashkëpunojnë gjatë arsimit formal.

16 Teksti bazohet në përcaktimet për sigurimin e interkulturalizmit të dhënë në Konceptim për arsim fillor <[https://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20-%20albanski%20jazik\\_1.pdf](https://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20-%20albanski%20jazik_1.pdf)>

17 Udhëzimi për organizimin e orëve të përbashkëta mësimore <[https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2022/02/Upatstvo-za-realizacija-na-zaednicki-nastavni-casovi\\_ALB.pdf](https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2022/02/Upatstvo-za-realizacija-na-zaednicki-nastavni-casovi_ALB.pdf)>

18 Ligji për Arsimin e Mesëm <<https://mon.gov.mk/al/page/?id=2055>>

Mundësia për realizimin e aktiviteteve të tilla është më e madhe në shkollat me dy/tri gjuhë mësimore sesa në shkollat njëgjuhëshe. Në kuadër të shkollave me dy/tre gjuhë mësimore zbatohen projekte të përbashkëta dhe hulumtime si pjesë e mësimin për lëndët obligative dhe realizohen orë të përbashkëta për lëndët zgjedhore (për të gjithë ose për një pjesë të madhe të tyre), trajnimi praktik dhe përmbajtjet e programuara nga shkollat në arsimin profesional si edhe aktivitetet e projektit në arsimin gjimnazor. Njëherësh, aktivitetet jashtëshkollore (si ekskursione, përvjetorë, punëtori njëditore, aksione ekologjike dhe humanitare, etj.) në këto shkolla organizohen dhe realizohen si aktivitete të përbashkëta me nxënës prej të gjitha gjuhëve të përfaqësuara mësimore.

Që të përmirësohet interaksioni midis nxënësve të gjuhëve të ndryshme mësimore, shkollat njëgjuhëshe stimulohen të formojnë partneritet me shkolla në një gjuhë tjetër mësimore dhe bashkërisht të planifikojnë, të organizojnë dhe të realizojnë vizita midis tyre ose takime onlajn në të cilat marrin pjesë grupe "të përziera" të nxënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore. Në këtë mënyrë, sigurohen aktivitete të përbashkëta jashtëshkollore (për shembull, punëtori njëditore, ekskursione, festa, aksione etj.) që i ndjekin rregullat për udhëheqjen bilinguale dhe trilinguale dhe bazohen në kriteret për aktivitete të përbashkëta.

Interkulturalizmi zhvillohet edhe përmes organizimit të punës së përgjithshme të shkollave dygjuhësore dhe tregjuhësore, që krijon kushte për komunikimin formal dhe joformal të mësimit dhe të nxënësve të etnive të ndryshme përmes përfaqësimit të obligueshëm të të gjitha gjuhëve mësimore në turnin e njëjtë, përmes aktiviteteve të përbashkëta profesionale me mësimit dhe të gjitha gjuhëve mësimore dhe përmes trupave të përbashkët në të cilët janë të përfshirë prindërit e të gjitha gjuhëve mësimore.

Në shkollat dygjuhëshe dhe tregjuhëshe është siguruar trajtim i barabartë i të gjitha gjuhëve të përfaqësuara mësimore që është e dukshme në përmbajtjen dhe mënyrën e ekspozimit të të gjitha përmbajtjeve vizuale dhe tekstuale në të gjitha hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë shkollës. Ky parim respektohet si për përmbajtjet e karakterit mësimor ashtu edhe për përmbajtjet informative, pavarësisht asaj se cilës bashkësi gjuhësore/kulturore/etnike i takojnë. Në shkollat njëgjuhëshe kujdes të veçantë duhet pasur me përmbajtjet vizuale dhe tekstuale të theksuara në hapësirat e përbashkëta që mos të nxitet etnocentrizmi, por përkundrazi, ta promovojnë Republikën e Maqedonisë së Veriut si shtet multikulturore/multi-etnik.

Mënyrat e dhëna për sigurimin e interkulturalizmit në arsimin e mesëm, nga aspekti i këtij dokumenti nënkuptojnë funksionimin e shkollave në frymën e interkulturalizmit.

Ky rregullim i arsimit të mesëm siguron zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave interkulturore të fituara në arsimin fillor.

Tek nxënësit e shkollave të mesme profesionale interkulturalizmi zhvillohet edhe përmes realizimit të trajnimit praktik tek një punëdhënësi, gjegjësisht në bashkësinë afariste ku punojnë, bashkëpunojnë, ndajnë përvoja dhe mësojnë të punësuar dhe nxënës të kulturave të ndryshme. Ky komunikim, bashkëpunim dhe mësim në vendin e punës jo vetëm se i zvogëlon stereotipat dhe paragjykimet por edhe vendos bashkëpunim interpersonal midis individëve, pjesëtarëve të kulturave të ndryshme (për shembull, mentor-nxënës, mentor-koordinator për trajnim praktik, nxënës-nxënës, etj.).

Realizimi i programeve ERAZMUS+ është edhe një mënyrë për përforcimin e kompetencave interkulturore të nxënësve. Përmes mobilizimit, nxënësit e vendeve të ndryshme komunikojnë dhe ndajnë dituri dhe përvoja. Kontakti dhe bashkëpunimi midis tyre, mundëson nxënësit t'i zgjerojnë pikëpamjet lidhur me ekzistimin e vlerave të ndryshme kulturore dhe ta kuptojnë nevojën dhe rëndësinë për respektimin e tyre.

# METODA TË REKOMANDUARA PËR ZHVILLIMIN E KOMPETENCAVE INTERKULTURORE

## 1 PËRVOJA

Mënyra më e mira për zhvillimin e kompetencave interkulturore është përmes përvojës së drejtpërdrejt, përmes përjetimit të drejtpërdrejt të diversitetit. Veçanërisht, përmes “përjetimit të përvojës së huaj”, respektivisht përvetësimit e diturisë për kulturat e tjera përmes përjetimit të drejtpërdrejt të asaj se si sillen, ndjejnë dhe mendojnë njerëzit nga perspektiva e tyre.

## 2 KRAHASIMI

Përmes krahasimit të botëkuptimeve të ndryshme mundësohet të shihen ngjashmëritë dhe dallimet dhe me këtë të gjendet baza e përbashkët për bashkëpunim dhe bashkëjetesë. Krahasimi, gjithashtu, mundëson të tejkalohet frika joracionale nga kultura e panjohur, ndërsa njohja e saj i rrënon barrierat e ndërsjella. Fundja, krahasimi, përfundimisht i thyen stereotipat dhe paragjykimet përmes thyerjes së kuptimeve të ngurtësuara për atë se çfarë është “normale” ose “jonormale”.

## 3 ANALIZË

Shqyrtimi i thellë, analitik në kulturën personale dhe kulturat e ndryshme, i shpalosë shtresat e fshehura të bindjeve, qëndrimeve dhe praktikave personale dhe të huaja. Kjo mundëson raport kritik ndaj kulturës personale dhe kulturës tjetër dhe shpjegim racional të mekanizmave të pavetëdijshme të sjelljes së njeriut. Analiza i shpalosë shtresat rrënjësore të qëndrimeve, mendimeve, sjelljeve të njeriut, si të kushtëzuara në aspektin kulturor.

---

**4**      *REFLEKTIMI*

Që të tria, metodat e lartpërmendura, duhet të jenë të shoqëruara me reflektimin, respektivisht të kalojnë nëpër thjerrëzën kritike të vetëreflektimit, me çka do të zhvilloheshin vetëdija dhe të kuptuarit. Reflektimi, „meditimi“ për kulturën „e përjetuar“, „krahësuar“ dhe „analizuar“ mundëson miratimin e gjykimit kritik, të filtruar dhe racional.

---

**5**      *VEPRIMI*

Të gjitha metodat e lartpërmendura duhet të përfundojnë me inicim të veprimit. Ato janë baza e qëllimit – aftësia për të ndërmarrë veprim „ndaj tjetrit“, „të shtrish dorën“, gatishmëri për të qenë tolerant, bashkëpunues, i ndjeshëm, solidar dhe i përgjegjshëm në situata konkrete. Nxitja e veprimit të nxënësit/nxënëses do të thotë përfshirjen e tij/saj në aktivitete, rrethimin dhe situata që i vendosin në test të gjithë hapat paraprak. Ky është zbatim në vepër i integritit interkulturore.

---

Si rrjedhojë, si qasje më adekuate për nxënie janë: **Nxënia përmes përvojës (Learning by doing)**, **Nxënia përmes bashkëpunimit** dhe **Nxënia përmes projekteve dhe aktiviteteve të projektit**.



STANDARDE  
PËR ARSIM  
INTERKULTUROR

në arsimin  
e mesëm